

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL - MINISTARSTVO ZA REGIONALNI RAZVOJ
MINISTRY OF REGIONAL DEVELOPMENT
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
DALËSE / DASHNA / OUTGOING
Nr./Br./No. 297
Nr.faq / Bt.str / No.pg 51 / 05 / 2023
Data / Datum / Date SA / OS / 2023
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal
2020-2030

(Periudha: Janar 2022-Dhjetor 2022)

Prishtinë, Mars 2023

Hyrje

Strategjia për Zhvillim Rajonal (2020-2030) është dokumenti themelor që përcakton kuadrin strategjik të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për arritjen e zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm të rajoneve zhvillimore, me qëllim të tejkalimit të dallimeve/pabarazive brenda dhe ndër-rajonale në kontekst të zbatimit të politikës evropiane të kohezionit dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe gjithëpërfshirëse.

Strategjia për Zhvillimit Rajonal (2020-2030) përcakton qëllimet dhe prioritetet afatgjate 10-vjeçare të politikës së zhvillimit rajonal, që mundëson koordinimin e politikave sektoriale në territorin përkatës të rajonit zhvillimor dhe mbështetë sinkronizmin mes tyre. Strategjia ka një rol të rëndësishëm për arritjen e përputhshmërisë dhe sinergjisë ndërmjet qëllimeve dhe prioritetëve të politikës së zhvillimit rajonal dhe politikave dhe strategjive sektoriale, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e balancuar të rajoneve zhvillimore.

Strategjia për zhvillim rajonal, përcakton politikat prioritare të Qeverisë, në nivel afatmesëm dhe jep orientimet strategjike zhvillimore afatgjate.

Me qëllim të monitorimit të implementimit të strategjisë për Zhvillim Rajonal, Ministria e Zhvillimit Rajonal, në bazë periodike harton raporte monitoruese për implementim të aktiviteteve sektoriale, aktiviteteve të komunave, OJQ-ve dhe aktiviteteve të MZHR, për të pasqyruar nivelin e realizimit dhe përmbushjes së detyrimeve sektoriale që dalin nga kjo strategji.

Raporti i shërben Qeverisë për të parë nivelin e zbatimit të strategjisë si dhe për të ri-orientuar nëse është e nevojshme politikat zhvillimore, i shërben institucioneve të cilat kanë përgjegjësi konkrete në zbatimin e aktiviteteve të kësaj strategjie, organizatave jo qeveritare, organizatave ndërkombëtare dhe të gjitha palëve tjera të interesuara, për të parë progresin e arritur nga fusha e zhvillimit rajonal, si dhe për orientimet programore për periudhën e ardhshme sa i përket zhvillimit rajonal.

MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR MONITORIM

Me qëllim të vendosjes së një mekanizmi monitorues, Ministria e Zhvillimit Rajonal, në cilësinë e institucionit përgjegjës për të monitoruar implementimin e strategjisë së zhvillimit rajonal, përmes planit të veprimit, ka përcaktuar aktivitetet dhe detyra konkrete, me afate të caktuara dhe me indikatorët përkatës, me qëllim të implementimit të strategjisë

për zhvillimin rajonal. Meqenëse strategjia për zhvillim rajonal, është strategji multi-sektoriale, janë përcaktuar institucionet përgjegjëse, të cilat mbështesin Minsitrinë e Zhvillimit Rajonal, në arritjen e objektivave të strategjisë, të vendosura nga Qeveria. Poashtu, me qëllim të pasqyrim të aktiviteteve për arritjen e objektivave si dhe realizimin e planit të implementimit të Strategjisë për Zhvillim Rajonal, Ministria për Zhvillim Rajonal harton raporte në baza periodike për të evidentuar progresin dhe sfidat në procesin e implementimit të strategjisë.

MZHR në përputhje me detyrimet e saj që përcaktojnë mandatin e saj, në mbështetje të UN-HABITAT projektit për shërbime të qëndrueshme komunale) ka koordinuar procesin e krijimit të mekanizmit monitorues të implementimit të strategjisë, me ç'rast janë evidentuar përgjegjësitë sektoriale të secilit institucion përgjegjës, apo mbështetës në nivelin qendror, komunave dhe shoqërisë civile.

Prandaj, me qëllim të evidencës së progresit për realizimin e aktiviteteve që dalin nga strategjia ka hartuar raportin 1 vjeçar të implementimit të strategjisë, për vitin 2022. Qëllimi i këtij raporti është identifikimi i aktiviteteve dhe rezultateve të arritura nga kjo strategji si dhe evidentimin e sfidave dhe hapave konkret për adresimin e tyre, me qëllim të arritjes së synimeve të përcaktuara nga Qeveria, për avancimin e zhvillimit rajonal.

Me qëllim të vendosjes së një mekanizmi ndër-sektorial për monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal, MZHR me vendim nr. 1197 ka themeluar grupin ndër-sektorial të cilët janë koordinatorët e procesit të implementimit të strategjisë për zhvillim rajonal, nën udhëheqjen e MZHR-së.

Në bazë të objektivave të caktuara dhe synimeve për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal 2020-2030, grupi ndër-sektorial për zbatimin e strategjisë është në përbërëje të institucioneve, si vijon:

- Ministria e Zhvillimit Rajonal;
 - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
 - Zyra e Kryeministrit - Zyra për Planifikim Strategjik, Departamenti për Asistencë Zhvillimore;
 - Ministria e Financave dhe Trasnfereve;
 - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
 - Ministria e Ekonomisë;
 - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
 - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
 - Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
 - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
 - Agjencia e Statistikave të Kosovës;
 - Asociacioni i Komunave të Kosovës;
 - Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Veri"
 - Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Jug"
 - Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Qendër"
 - Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Lindje"
 - Agjensioni Zhvillimor Rajonal "Perëndim"
 - Përfaqësues nga Shoqëria Civile;
 - Përfaqësues nga donatorët dhe partnerët ndërkombëtar;
- Grupi Punues takohet në baza të rregullta dhe raporton në bazë periodike, sipas kërkesave të MZHR.

LISTA E SHKURTESAVE

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
ZKM	Zyra e Kryeministrit
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MFT	Ministria e Financave dhe Transfereve
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMPHI	Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ME	Ministria e Ekonomisë
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
AZHR	Agjension për Zhvillimor Rajonal

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Strategjia për Zhvillim Rajonal ka gjithsej tri objektiva:

Objektivi Strategjik: 1. Koordinimi i politikave për zhvillim rajonal;

Objektivi Strategjik: 2. Zhvillimi rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale;

Objektivi Strategjik: 3. Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane.

Në kuadër të objektivit 1, me qëllim të realizimit të aktiviteteve konkrete, janë parashikuar dy objektiva specifike, si vijon:

***Objektivi Specifik: 1.1** Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar;*

***Objektivi Specifik: 1.2** Themelimi i mekanizmave institucional për zhvillim rajonal, për hartimin monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve dhe performancës rajonale.*

Në objektivin 2, janë parashikuar edhe 4 objektiva specifike, si vijon:

***Objektivi Specifik: 2.1** Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioriteteve në bazë të vlerësimeve;*

***Objektivi Specifik: 2.2** Reduktimi i pabarazive përmes ndihmës financiare të balancuar në sektorin privat dhe publik;*

***Objektiv Specifik: 2.3** Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;*

***Objektivi Specifik: 2.4** Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonal përmes programeve trans nacionale.*

Në objektivin 3, janë parashikuar edhe 3 objektiva specifike:

***Objektivi Specifik: 3.1** Inventarizimi i resurseve, natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane;*

***Objektivi Specifik: 3.2** Ndërtimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve;*

***Objektiv Specifik: 3.4** Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.*

Ndërsa, me qëllim të evidentimit të objektivave të strategjisë, janë vendosur synimet si vijon (të pasqyruara në tabelën 1), të cilat do të monitorohen dhe do të vlerësohen nga aspekti implementimit përmes planit të veprimit dhe raporteve monitoruese:

Synimet e përcaktuara deri në vitin 2022, për realizimin e objektivave strategjike të strategjisë për zhvillim rajonal	Vlera bazë 2020	Synimi 2022
Kornizë ligjore e përafruar me legjislacionin e BE-së, në fushën e zhvillimit rajonal		
Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar	0%	60%
Themelimi i mekanizmave institucional për zhvillim rajonal, për hartimin monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve dhe performancës rajonale.	20%	100%
Zhvillim rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale		
Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioriteteve në baze të vlerësimeve.	0%	15%
Reduktimi i pabarazive përmes ndihmës financiare të balancuar në sektorin privat dhe publik	0%	17%
Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar	0%	30%
Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonal përmes programeve trans nacionale.	0%	25%
Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane;		
Resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane të qëndrueshme dhe të promovuara.	0%	45%
Ndërtimi i kapaciteteve humane dhe të OSHC-ve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik rajonal.	0%	15%
Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socioekonomik rajonal të balancuar	0%	10%

OBJEKTIV STRATEGJIK: 1. KOORDINIMI I POLITIKAVE PËR ZHVILLIM RAJONAL;

Objektivi Specifik 1.1. - Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Veprimi -1.1.1 Hartimi dhe miratimi i kornizës ligjore për zhvillim rajonal të balancuar ;

("Institucioni Kryesor: MZHR: Institucione mbështetëse: Ministrinë e linjë, Mbështetja nga donatorët: GIZ")

Projektligji për Zhvillim Rajonal të Balancuar është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me 26.10.2022, ka qenë në rend ditës në Kuvendin e Republikës së Kosovës në fund të vitit 2022 për lexim të parë.

Veprimi- 1.1.2 Hartimi i dokumentacionit shpjegues të legjislacionit për zhvillim rajonal të balancuar;

("Institucioni Kryesor: MZHR: Institucione mbështetëse: Ministrinë e linjë, ZKM, MF, ASK")

Është themeluar grupi punues për hartimin e dokumentit shpjegues, nga MZHR është hartuar dokumenti shpjegues për politikat rajonale në Bashkimin Evropian që pasqyron zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal, të inkuorporuar si: objektiva, prioritetet, dhe koncepte, që ofrojnë mundësi të barabarta për zhvillim të balancuar rajonal. Dokumenti Shpjegues është miratuar në nivel të ministrisë dhe është publikuar në uebfaqë të MZHR-së.

Objektivi specifik 1.2. -Themelimi i mekanizmave institucional për hartim, monitorim, dhe vlerësim të programeve/projekteve dhe performancës rajonale;

Veprimi -1.2.1 Themelimi i mekanizmave institucional për hartim, monitorim, dhe vlerësim të programeve/projekteve dhe performancës rajonale;

("Institucioni Kryesor: MZHR")

DZHR/MZHR ka krijuar grupet Monitoruese /Mbikëqyrëse për të gjitha Programet e Zhvilluara nga MZHR, si dhe janë formuar grupet/komisionet vlerësuese/monitoruese për Programet e MZHR-së.

Veprimi -1.2.2 Analiza mbi vlerësimin e fushave të nevojshme për investime me impakt rajonal;

("Institucioni Kryesor: MZHR")

Janë ndërmarrë të gjitha veprimet për krijimin e ekipeve, grupeve, sistemeve dhe mekanizmave për krijimin e data bazës elektronike dhe gjenerimin e të dhënave sipas Rajoneve, Profileve/Sektorëve dhe specifikave tjera.

MZHR në kuadër të nënqëllimit strategjik “Analiza mbi vlerësimin e fushave të nevojshme për investime me impakt rajonal” vitin 2022, ka hartuar analizën për pasqyrimin dhe avancimin e zhvillimit rajonal prej periudhës 2017-2021 ku janë indetifikuar dhe trajtuar gjithë hapat dhe veprimet që MZHR ka ndërmarrë gjatë periudhës pesë (5) vjeçare dhe ka kontribuar përmes mekanizmave, politikave dhe programeve në avancimin e zhvillimit rajonal sipas rajoneve zhvillimore. Gjithashtu MZHR ka hartuar edhe analiza të rregullta vjetore që i kontribuojnë indetifikimit të fushave / sektorëve më të investuar dhe atyre më pak të investuar si dhe shpërndarjen e balacuar të investimeve në rajone zhvillimore.

Veprimi_-1.2.3. Zhvillimi i sistemit për matjen e performancës rajonale;
("Institucioni Kryesor: MZHR, Komunitat")

MZHR ka realizuar ngritjen e kapaciteteve humane në Departmentin për Planifikim dhe Analiza Socio Ekonomike Rajonale (DPASER), përmes pjesëmarrjes në trajnimet profesionale të sistemit (SPSS) në IKAP për të aplikuar sistemin për matjen e performancës, si qasje analitike përmes SPSS. Ky sistem është punuar në bashkëpunim me Universitetin e Shkencave Aplikative të Ferizajit, ku janë vendosur dhe strukturuar në SPSS sipas rajoneve, 14 fusha specifike dhe 93 tregues për matjen e performancës rajonale. Ky sistem pritet të funksionalizohet në vitin (2023). Gjithashtu DPASER referuar politikave strategjike të MZHR-së ka hartuar edhe Termat e Referencës të cilët janë konsultuar me GIZ dhe USHAF për tu publikuar dhe në bazë të tyre për tu zhvilluar një ueb sistem në vitin 2024, i cili në kohën reale do të agregojë të dhëna statistikore nga ministritë e linjes, komuna dhe akterë tjerë relevant.

MAPL ka draftuar projektligjin për menaxhimin e Përfomrancës Komunale dhe Grantin e Përfomrancës, i cili ligj është aprovuar në qeveri dhe është miratuar dhe publikuar në gazetën zyrtare më datë 12.08.2022.

OBJEKTIVI STRATEGJIK: 2. ZHVILLIM RAJONAL I BALANCUAR DHE RAJONE TË AFTA PËR KONKURRENCË NDËR RAJONALE

Objektivi specifik 2.1 - Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioriteteve në baze të vlerësimeve.

Veprimi - 2.1.1. Krijimi i data bazës rajonale me të dhëna socio-ekonomike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MFT, ASK)

Docu Share (DZHR) Data baza e brendshme e programeve që implementon MZHR nga viti 2018-2022, duke përfshirë programet:

- Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar;
- Programi për Zhvillim Rajonal;
- Programi për OJQ.

Veprimi - 2.1.2. Identifikimi i investimeve publike nga niveli qendror sipas rajoneve zhvillimore, zbërthyer edhe sipas komunave;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MINT, MAPL)

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka përgatitur kriteret për aplikim të financimit të projekteve të komunave nga programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike të cilat me vendim të qeverisë janë aprovuar. Nga ky program komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal janë realizuar 12 projekte në 14 komuna vlerë prej 734,951.47 €.

Nga programi për bashkëfinancim me donatorë bazuar në skemën e grantit për performancë të komunave në bashkëpunim me projektin DEMOS dhe donatorët e tjerë janë 14 komunat përfituese me 60 projekte në vlerë prej 6,556,687.39 €, ku nga buxheti i MAPL janë 8 komuna përfituese me 25 projekte në vlerë prej 1,556,687.39 € dhe nga buxheti i DEMOS janë 6 komuna përfituese me 35 projekte në vlerë prej 5,000,000.00€.

Nga Programi "Mbështetja për projektet infrastrukturore për komunitete në Komunitet e Republikës së Kosovës", janë financuar 28 projekte në 20 komuna në vlerë prej 927,758.23 €.

Veprimi - 2.1.3. Pasqyrimi sipas rajoneve zhvillimore të resurseve natyrore;
(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Në bashkëpunim me MKRS dhe MZHR-në, është formuar grupi punues për dokumentin "Pasyqrimi i inventarizimit kulturor sipas rajoneve zhvillimore", i cili është i publikuar në ueb faqen zyrtare të MZHR-së në gjuhën Angleze dhe Serbe. Dokumenti është konsultuar me strukturat menaxheriale në MZHR, MKRS dhe aktere tjerë relevant dhe është miratuar.

Objektivi Specifik: 2.2 - Reduktimi i pabarazive përmes ndihmës financiare të balancuar në sektorin privat dhe publik;

Veprimi -2.2.1. Analiza e investimeve kapitale sipas rajoneve zhvillimore;
(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

MZHR specifikisht Departmenti për Planifikim dhe Analiza Socio Ekonomike Rajonale (DPASER) ka formuar grupin punues për të mbledhur të dhëna të investimeve kapitale për vitin paraprak (2021) është realizuar, po ashtu të dhënat janë sistemuar sipas rajoneve zhvillimore në data bazën e DPASER-it. Të dhënat janë mbledhur sipas formateve të përcaktuara nga DPASER në formatin EXCEL. Dokumenti ka realizuar të gjitha konsultimet me nivelin qendror, komuna dhe ASK, si dhe ka realizuar puntorinë për të bërë verifikimin dhe validimin e të dhënave me të gjithë akterët e përfshirë. Janë themeluar mekanizmat që raportojnë për të dhënat dhe investimet kapitale nga secili Institucion (Ministritë e Linjës dhe ASK). Dokumenti është finalizuar, aprovuar dhe publikuar në faqen zyrtare të MZHR-së. Dokumenti pasqyron sektorët me të investuar sipas rajoneve zhvillimore nga niveli qendror dhe lokal. Gjithashtu pasqyron edhe shpërndarjen e balancuar të investimeve në pesë rajonet me të cilat operon MZHR, specifikisht identifikon komunat që nuk kanë pranuar investime kapitale nga niveli qendror. Në dokument gjinden edhe të dhënat si investimet për kokë banori nga niveli qendror dhe lokal të shpërndara sipas rajoneve zhvillimore.

Veprimi -2.2.2. Analiza e shpërndarjes së granteve në sektorin privat nga niveli qendror në rajone; (Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MFT)

Është krijuar grupi punues për hartimin e dokumentit/analizës së shpërndarjes së granteve në sektorin privat nga niveli qendror në rajone pasqyron skemat e granteve të MZHR-së, MINT, Inovacionit dhe MBPZHR dhe shpërndarjen e përkrahjes sipas rajoneve zhvillimore me të cilat operon MZHR-ja. Identifikon shpërndarjen e balancuar sipas rajoneve zhvillimore, numrin e projekteve, përfituesit sipas gjinisë, sipas përkatësisë

etnike, sipas veprimtarive dhe sektorëve dhe komunat që kanë përfituar përkrahje në ato rajone zhvillimore. Analiza është e finalizuar dhe publikuar në ueb faqen e MZHR-së.

Veprimi -2.2.3. Hartimi dhe Implementimi i programit të zhvillimit rajonal me grante për komuna për përmirësimin e infrastrukturës publike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

Janë dizajnuar kriteret për grande në infrastruktur publike, është hapur thirrja publike për aplikim, janë krijuar mekanizmat/ ekipet monitoruese për monitorim dhe raportim lidhur me implementimit e grandeve në infrastrukturës publike, janë hartuar raportet periodike lidhur me implementimin e programit për zhvillim rajonal në përmirësimin e infrastrukturës publike.

MZHR në vitin 2022 gjithsej ka realizuar 17 projekte në 16 komuna të Republikës së Kosovës. Shuma e financuar për vitin 2022 ka qenë në vlerë **1,714,000.00 euro**

MZHR ka raportu këto Investime kapitale në pesë (5) rajone zhvillimore për vitin 2022 si në vijim:

1. *Rajoni Zhvillimor Qendër:* Podujeva, Drenasi, Shtime, në vlerë prej: 249,677.43 €;
2. *Rajoni Zhvillimor Veri:* Mitrovica Jugore, Leposaviq, Zubin Potok, Vushtrri në vlerë prej 226,351.24 €;
3. *Rajoni Zhvillimor Perëndim:* Istog, Junik, Deçan në vlerë prej: 414,246.73 €;
4. *Rajoni Zhvillimor Jug:* Rahoveci, Suhareka, Dragashi dhe Mamushë në vlerë prej: 308,767.14 €;
5. *Rajoni Zhvillimor Lindje:* Viti, Kamenicë në vlerë prej: 223,618.53 €.

Veprimi -2.2.4. Hartimi dhe Implementimi i programit për zhvillim rajonal të balancuar me grante në sektorin privat;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

Janë dizajnuar kriteret për grande në sektorin privat, është hapur thirrja publike për aplikim, janë krijuar mekanizmat/ ekipet monitoruese për monitorim dhe raportim lidhur me implementimit e grandeve për biznese në sektorin privat, janë hartuar raportet periodike lidhur me implementimin e programit për zhvillim rajonal në sektorin privat. Në vitin 2022 nga Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (përkrahja e bizneseve PZHRB 2022): nga 339 Projekt Propozime që kanë nënshkruar kontratat me MZHR-në janë implementuar 332 Projekt Propozime dhe janë krijuar 850 vende pune. Mjetet e destinuar për këtë thirrje kanë qenë në shumën prej: 3,032,503.06 €.

Objektiv Specifik: 2.3 - Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Veprimi -2.3.1. Hartimi i politikave për zhvillim të balancuar rajonal;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Janë themeluar Grupet Punuese për hartimin e analizave. Janë hartuar Analizat e shpërndarjes së granteve në sektorin privat nga niveli qëndror në rajone, për vitin 2022 dhe janë publikuar në uebfaqe të MZHR-së.

Veprimi -2.3.2. Zhvillimi i programit për promovimin e politikave zhvillimore të rajoneve socio-ekonomike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MINT)

MZHR është Anëtare e Forumit për Zhvillimin e Politikave Industriale (FZHPI) të themeluar nga MINT. MZHR ka qenë çdo herë pjesëtarë i takimeve ku jemi ftuar nga MINT në kuadër të FZHPI, që nga viti 2021 nuk kemi pranuar ftesë meqenëse nuk janë mbajtur takime si pasojë e efekteve negative nga COVID 19.

Objektivi Specifik: 2.4 - Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonat përmes programeve trans nacionale;

Veprimi -2.4.1. Përgatitja e plan programit për anëtarësim dhe kërkesa për anëtarësim në programet: EURO-MED, ADRION dhe DANUB;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

MZHR ka organizuar takime me ZKM dhe MPJD lidhur me bashkëpunimin dhe bashkëveprimin. Jemi në pritje të informatave nga grupi punues ZKM-DMPJ, sa i përket të dhënave të anëtarësimin të Republikës së Kosovës në Organizatat Ndërkombëtare dhe Nismat Rajonale, si dhe në vlerësimin e programeve me mundësi pjesëmarrje. Janë realizuar aktivitetet sipas planit dhe janë realizuar 2 takime me zyrën e BE-së, janë mbajtur 4 takime me vendet fqinje: Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, Turqinë. Gjithashtu, është kryer koncepti i konferencës, Ftesa dhe Agjenda, kurse mbajtja e Konferencës për ZHR është realizuar më datë 24 - 25 Mars 2022 konferencë dy ditore me temë "Sfidat dhe perspektiva e zhvillimit rajonal në Ballkanin Perëndimor". Gjatë këtyre dy ditëve është diskutuar për bashkëpunimin i ardhshëm në fushën e zhvillimit rajonal, avancimin e politikave socio-ekonomike të balancuara, shkëmbimin e përvojave lidhur me praktikën dhe programet në fushën e zhvillimit rajonal mundësitë për pjesëmarrjen; programet trans nacionale dhe projektet e bashkëpunimit ndërkufitar mes shteteve. Kjo ishte "Konferenca e Parë Ndërkombëtare e Zhvillimit Rajonal në Prishtinë e cila ishte një mundësi e rritjes së bashkëpunimit ndërmjet shteteve tona.

Veprimi -2.4.2. Përgatitja e planit të bashkëpunimit me sekretariatet e programeve transnacionale: EURO-MED, ADRION dhe DANUB;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

MZHR ka avansuar dokumentet fillestare për pjesëmarrje në Programet Transnacionale (Euro-MED, Adrion dhe Danub). Janë vënë kontaktet me programin Euro-MED, lidhur me prezantimin e objektivave, mënyrës së financimit të tyre, etj. Është avansuar dokumenti për qasje në programin Euro-MED. MZHR me datë 09.06.2022 ka marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga programi transnacional për rajonin e Danubit me temën “Të rinjtë në kohë krize”, që ka për qëllim ndërtimin e një sistemi të arsimit të përgjegjshëm, trajnimit dhe tregut të punës në Rajonin e Danubit. MZHR me datë 05.08.2022 ka mbajtur takim online me përfaqësuesit e programit transnacional Adrion, z. Lodovico Gherardi - Koordinatorë i Autoriteteve Menaxhuase në Programin trans-nacional Adrion, si dhe znj. Barbara Di Piazza nga Sekretariati i Përbashkët i programit trans-nacional Adrion. Qëllimi i takimit ishte që Kosova përmes Ministrisë së Zhvillimit Rajonal të kryqet në nismat rajonale, sikurse shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor përmes programit transnacional Adrion. Po ashtu është mbajtur takimi virtual me Euro-MED lidhur me organizimin e një vizite studimore në programin trans-nacional Euro MED.

OBJEKTIVI STRATEGJIK: 3. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM RAJONAL BAZUAR NË RESURSE NATYRORE, EKONOMIKE, KULTURORE DHE HUMANE

Objektivi specifik- 3.1 - Resurseve, natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane të qëndrueshme dhe të promovuara;

Veprimi - 3.1.1. Krijimi i data bazës për Inventarizimin e resurseve natyrore, ekonomike dhe kulturore sipas rajoneve zhvillimore;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MMPHI, MINT)

MZHR respektivisht DPASER ka krijuar data bazën rajonale në ECXEL sipas pesë rajoneve zhvillimore me të gjitha të dhënat nga lista e trashëgimisë kulturore dhe listat e objekteve kulturore (të dhëna primare të pranuar nga (MKRS). Gjithashtu në kuadër të planeve strategjike të MZHR-së pritet që në vitin 2024 MZHR të ketë një ueb sistem për mbledhjen e të dhënave në kohë reale dhe ndërlidhjen e saj me ueb sistemet tjera të operimit.

Veprimi - 3.1.2. Krijimi i data bazës për identifikimin e burimeve njerëzorë sipas profileve profesionale sipas rajoneve zhvillimore;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ASK, MFT ministritëe Linjës dhe donatorët)

Kjo data bazë i referohet vjetarit të statistikave të Kosovës për vitin 2022 kapitullit IX Statistikat e tregut të punës. Meqenëse Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK) në fund të vitin 2022 i ka aprovuar NUTS rajonet, ku kosova tash ka të klasifikuara shtatë NUTS 3 rajone, edhe në vitin 2022 nuk është prezantuar data baza sipas këtyre rajoneve. Në vitin 2023 pritet që edhe ligji për zhvillim rajonal të balancuar të aprovohet në leximin e dytë i cili parasheh 7 rajone zhvillimore të harmonizuara me NUTS 3 me qëllim të harmonizimit të të dhënave me ASK.

TAB 9.10: NORMA E PUNËSIMIT SIPAS AKTIVITETEVE EKONOMIKE DHE GJINISË 2001-2020

(vazhdim)

Aktivitetet ekonomike (NACE REV2)	2016			2017			2018			2019			2020		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
A Bujqësi, pylltari dhe peshkatar	4,8	2,3	4,2	4,7	3,3	4,4	4,2	1,0	3,5	5,9	2,8	5,2	5,4	3,1	4,8
B Xehetari dhe guroret	1,4	0,0	1,1	1,4	0,2	1,2	1,1	0,1	0,9	0,8	0,0	0,6	1,3	0,3	1,1
C Prodhim	15,4	5,8	13,2	14,8	7,0	13,2	11,4	6,1	10,3	13,9	5,3	11,9	13,2	7,6	11,8
D Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe furnizimi me ajr të kondicionuar	2,1	0,2	1,6	2,2	0,6	1,8	2,3	0,1	1,8	1,8	0,4	1,4	2,7	0,7	2,2
E Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	2,3	0,9	2,0	1,4	0,6	1,2	1,5	0,4	1,3	1,3	0,4	1,1	1,4	0,4	1,2
F Ndërtimtari	14,7	0,5	11,5	16,2	0,6	12,9	14,8	1,2	11,9	15,9	1,2	12,6	14,5	0,7	11,1
G Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	14,2	17,1	14,8	14,8	14,0	14,7	16,8	17,7	17,0	16,5	18,7	17,0	16,4	18,8	17,0
I Transport dhe ruajtje	3,8	1,1	3,2	3,2	0,8	2,7	3,8	1,4	3,3	4,4	1,1	3,7	4,3	1,1	3,5
H Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	7,1	3,8	6,4	7,3	3,8	6,6	7,7	3,6	6,9	7,0	4,6	6,4	6,7	4,6	6,2
J Informacion dhe komunikim	2,1	2,5	2,2	2,6	2,9	2,6	3,5	3,2	3,4	3,5	4,7	3,8	4,0	4,0	4,0
K Aktivitete financiare dhe të sigurimit	1,7	2,9	1,9	1,5	2,7	1,7	1,7	3,2	2,0	1,6	2,2	1,7	1,7	2,0	1,8
L Aktivitete të palundshmërisë	0,1	0,0	0,1	0,0	0,1	0,1	0,1	0,0	0,1	0,1	0,2	0,1	0,2	0,1	0,1
M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	1,9	2,2	2,0	2,2	2,3	2,2	1,5	2,6	1,8	2,5	3,4	2,7	2,8	3,9	3,1
N Aktivitete administrative dhe mbështetëse	3,5	2,4	3,3	4,2	2,6	3,8	2,9	2,8	2,9	4,0	3,7	3,9	4,0	5,1	4,3
O Administratë publike dhe mbrojtje; sigurim social i detyrueshëm	7,4	7,3	7,4	5,8	7,3	6,1	7,1	6,5	7,0	6,8	5,6	6,6	7,0	5,9	6,7
P Arsimit	7,7	20,5	10,6	7,1	18,4	9,5	8,5	21,8	11,3	6,8	20,7	10,0	6,8	20,1	10,1
Q Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	3,3	13,8	5,6	3,9	16,0	6,5	3,7	13,4	5,8	2,8	13,6	5,3	3,5	13,8	6,1
R Art, zbavitje dhe rekreacion	1,5	2,4	1,7	1,3	1,5	1,4	1,5	0,8	1,3	1,4	1,1	1,3	1,0	1,2	1,1
S Aktivitete të shërbimeve tjera	3,4	4,3	3,6	4,0	5,9	4,4	4,8	5,1	4,8	1,9	5,7	2,7	2,1	4,6	2,7
T Aktivitete të ekonomive familjare si punëdhënës; mallra dhe shërbime	0,8	8,8	2,6	0,7	7,0	2,1	0,4	6,8	1,7	0,4	3,9	1,2	0,4	1,5	0,7
U Aktivitete të organizatave dhe organeve jashtë-territoriale	0,8	1,3	0,9	0,6	2,5	1,0	0,7	2,0	1,0	0,7	0,6	0,7	0,6	0,7	0,6

Objektivi Specifik: 3.2- Ndërtimi i kapaciteteve humane dhe OSHC-ve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik rajonal;

Veprimi - 3.2.1. Ngritja e kapaciteteve humane të nivelit lokal për shfrytëzimin e resurseve natyrore, përmes përkrahjes financiare;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes Thirrjes Publike që realizon çdo vit për mbështetjen financiare të projekteve/programeve të QJQ-ve për avancimin e zhvillimit socio ekonomik rajonal të balancuar ka mbështetur Organizata Joqeveritare të udhëhequra nga gratë edhe të rinjtë, me një numër të mirë të projekteve. Në total janë financuar 38 projekte për vitin 2022 me vlerë 104 mijë euro.

Veprimi - 3.2.2. Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve tek të rinjtë për identifikimin e mundësive të vetëpunësimit dhe krijimin e bizneseve "start up";

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Janë realizuar 7 trajnime me përfituesit nga programi PZHRB 2022 për zbatim të projekteve, si dhe nga 38 OJQ-të përfituese janë realizuar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve për ngritje të kapaciteteve të të rinjëve dhe grave për mundësitë e punësimit. MZHR ka realizuar trajnime me përfituesit nga programi PZHRB 2022 për zbatim të projekteve, si dhe nga 38 OJQ-të përfituese janë realizuar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve për ngritje të kapaciteteve të të rinjëve dhe grave për mundësitë e vetëpunësimit ku kanë përfituar rreth 200 pjesëmarrës.

Objektiv Specifik: 3.3 - Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Veprimi - 3.3.1. Ndarja e granteve në bashkëpunim me komunat për përmirësimin e infrastrukturës publike (Investime kapitale) të zonave ekonomike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

MZHR ka dizajnuar kriteret për ndarjen e granteve në bashkëpunim me komunat për përmirësimin e infrastrukturës publike (Investime kapitale) të zonave ekonomike si në vijim:

- Rregullimi i objektit për inkubator biznesi, në Komunë Vitisë;
Shuma e paguar nga MZHR - 140,000.00 €, të zotuara për vitin 2023 - 250,000.00 €;
- Parku Teknologjik në Komunën e Kamenicës;
Shuma e paguar nga MZHR - 83,618.53 €;
- Ndërtimi i infrastrukturës në zonen biznesore në Banje në Komunën Istog;
Shuma e paguar nga MZHR - 75,000.00 €;
- Mbështetja e zhvillimit të hovshëm të prodhimeve bujqësore nëpërmjet sigurimit të infrastrukturës elektrike në zonën e serave, në Komunën e Mamushës;
Shuma e paguar nga MZHR - 150,000.00 €.

Veprimi - 3.3.2. Ndarja e granteve për rritjen e kapaciteteve prodhuese të bizneseve në zonat ekonomike me theks të veçantë për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar;
(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, OJQ)

MZHR ka ndërmarrë veprime konkrete përmes organizimit të punëtorive dhe sesioneve informuese për promovim të formave të bashkëpunimit për zhvillimin socio-ekonomik. (MZHR).

Në vitin 2022, **AZHR Veri** ka implementuar projektin "Zhvillim rajonal i balancuar – Rajoni Veri i aftë për konkurrencë ndër-rajonale";

- 24 kontrata të bizneseve të Parkut të Biznesit në Mitrovicë Jugore të nënshkruara;
- Bordi i Parkut të Biznesit në Mitrovicë functional;
- Draft modelet e kontratave për Zonën Industriale në Lumadh, Vushtrri të përgatitura;
- Vizitat studimore në Mitrovicë (e organizuar);
- Plani i Veprimit për Strategjinë e Turizmit të Skenderaj i Finalizuar dhe aprovuar.

Në vitin 2022, **AZHR Qendër** ka implementuar projektin "Zyrtarët komunal më të shkathët në promovimin e Zhvillimit Socio – Ekonomik Rajonal të Balancuar përmes Menaxhimit të Ciklit të Projekteve, financuar nga MZHR.

- Trajnimi i 20 zyrtarëve komunal për 5 ditë në "Menaxhimi i ciklit të projekteve dhe qasja në kornizën logjike";
- Punëtori 2 ditore me zyrtarë komunal në përgatitjen e projekt koncepteve komunale dhe rajonale;
- Bashkë-organizimi i konferencës ndërkombëtare 2 ditore së bashku me MZHR;
- Organizimi i tryezës së rrumbullakët rajonale "Parteriteti në zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal në Republikën e Kosovës" me kryetarët e komunave dhe përfaqësues të lartë të MZHR-së.
- Bashkë-organizimi (së bashku me 4 AZHR-të tjera) i takimit jo-formal me përfaqësuesit e Zyrës së BE-së në Kosovë, MZHR, dhe kryetarët e komunave të Kosovës.

1. Në vitin 2022, **AZHR-Perëndim** ka zbatuar projektin e financuar nga MZHR "Fuqizimi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar në Rajonin Perëndimorë të Kosovës përmes ngritjes së kapaciteteve", përmes të cilit janë realizuar pesë (5) module të trajnimit me zyrtar komunal të 6 komunave në rajonin perëndimorë. Të gjitha këto module të realizuara gjatë një periudhe tre mujore kanë qenë të ndërlidhura me menaxhimin e ciklit të projekteve, të bazuar në metodologjinë e BE-së. Të gjitha gjashtë Komunitet e rajonit kanë qenë të përfaqësuara me së paku 2 përfaqësues, ndërsa modulet janë zhvilluar në formën e ligjeratave dhe ushtrimeve praktike në zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve.

2. Gjatë muajit Tetor 2022, AZHR-Perëndim ka mbështetur MZHR-në në organizimin e një tryeze me 6 Komunat e rajonit perëndimor lidhur me prezantimin dhe shqyrtimin e draft dokumenti "Kriteret për brendimin e rajoneve zhvillimore".

Në vitin 2022, **AZHR Lindje** ka implementuar projektin "Ngritja e kapaciteteve të Komunave dhe Promovimi i Zhvillimit Rajonal", financuar nga MZHR.

- Trajnimi i 20 zyrtarëve komunal për 3 ditë në "Menaxhimi i ciklit të projekteve dhe qasja në kornizën logjike";
- Punëtori 2 ditore me 20 zyrtarë komunal në përgatitjen e projekt koncepteve komunale dhe rajonale;
- Bashkë-organizimi i konferencës ndërkombëtare 2 ditore së bashku me MZHR;
- Organizimi i tryezës së rrumbullakët rajonale "Parteriteti në zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal në Republikën e Kosovës" me kryetarët e komunave dhe përfaqësues të lartë të MZHR-së;
- Bashkë-organizimi (së bashku me 4 AZHR-të tjera) i takimit joformal me përfaqësues të Zyrës së BE-së në Kosovë, MZHR dhe kryetarët të komunave të Kosovës.

Në vitin 2022, **AZHR Jug** ka implementuar projektin "Ngritja e kapaciteteve lokale për krijimin e ambientit më të favorshëm për të bërë biznes si dhe avansimi i dialogut ndërmjet MZHR-së dhe hisedarëve të tjerë rajonal në rajonin jug", me një vlerë të përgjithshme prej 7000 Euro me këto aktivitete si më poshtë:

- Trajnimi i 12 zyrtarëve komunal për 5 ditë në fushën e krijimit të skemave për përkrahjen e bizneseve sipas modelit vendor (MZHR);
- Trajnimi i 12 zyrtarëve komunal për 5 ditë në fushën e krijimit të skemave për përkrahjen e bizneseve sipas modelit të BE;
- Asistencë teknike direkt për 30 ditë (nga 5 ditë në 6 komuna) me zyrtarët komunal në zyret komunale për 5 ditë në 6 komuna për krijimin e skemave;
- Organizimi dhe mbajtja e një konference rajonale 2 ditore mes MZHR-së dhe hisedarëve lokal dhe rajonal.

Veprimi - 3.3.3. Promovimi i politikave rajonale dhe kushteve të cilat ofrohen për tërheqjen e investitorëve te huaj në rajone zhvillimore;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

Është finalizuar studimi i fizibilitetit për rajonet zhvillimore ku janë pasqyruar të dhënat e rajoneve zhvillimore që përfshijnë kategoritë e resurseve natyrore dhe socio-ekonomike.

Veprimi - 3.3.4. Analizimi i investimeve nga niveli qendror në zonat ekonomike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

Krijimi i Grupit Punues. DPASER gjatë vitit 2022, ka avancuar edhe me tej në bashkëpunim me MINT raportin për funksionalizimin e zonave ekonomike. Raporti identifikon gjitha zonat ekonomike funksionale dhe ato jo funksionale, numëri i bizneseve që operojnë, veprimtaritë, punësimin, identifikimin e tyre në hartat kadastrale. MZHR përmes programeve të saj, PZHRB dhe PZHR mbështet bizneset që operojnë në zona ekonomike dhe mbështet komunat të cilat aplikojnë me projekte në mbështetje të infrastrukturës në zonat ekonomike. Raporti është konsultuar me MINT dhe komunat përgjegjëse dhe gjendet i publikuar në uef faqen zyrtare të MZHR-së.

VLERËSIM I PËRGJITHSHËM LIDHUR ME TË ARRITURAT DHE REZULTATET
PËR IMPLEMENTIM TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIM RAJONAL PËR VITIN 2022

- ✓ Përgatitja e analizës krahasimore për praktikat e zhvillimit rajonal në vendet e rajonit dhe vendet e BE-së;
- ✓ Zbatimi i tri programeve zhvillimore të MZHR-së;
- ✓ Finalizimi i draftit të Projekt-Ligjit për Zhvillim Rajonal dhe miratimi në qeveri;
- ✓ Krijimi i mekanizmit monitorues për monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit Rajonal;
- ✓ Përfundimi i analizave socio-ekonomike sipas rajoneve zhvillimore;
- ✓ Zbatimi i tri programeve zhvillimore të MZHR-së për vitet 2022;
- ✓ Vënia e kontakteve me tri programet transnacionale EUROMED, ADRION dhe DANUB.